

Shejhu i nderuar
ABDURRAHMAN IBN NASIR ES SA'DI

TË MËSOJMË
BAZAT E BESIMIT



Titulli në original:

تعليم أصول الإيمان

Autor:

Abdurrahman ibn Nasir ES SA'DI

Përktheu:

Ylli RAMA

Redaktorë fetarë:

Edmond AJDINI, Shuaib REXHA

Redaktor gjuhësor:

Sashenka JAUPI

Ballina dhe realizimi teknik:

Avni G GASHI

Boton:

Qendra “Udha e Besimtarëve”, 2015



Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

PARATHËNIA E AUTORIT

Lavdërimi i takon Allahut për emrat e Tij të bukur, cilësitë e Tij të përsosura dhe për mirësitë e Tij të shumta.

Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, i cili u dërgua si mëshirë për mbarë botët.

Ky libërth përmbledh çështjet më të rëndësishme të fesë; bazat e besimit, të cilat duhet të njihen nga të gjithë. Libërthin e kam përpiluar në trajtën e pyetje-përgjigjeve sepse kjo mënyrë është më e qartë për t'u kuptuar, më e lehtë për t'u përvetësuar dhe njëherazi për t'jua mësuar të tjerëve.

KAPITULLI I PARË

ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME LIDHUR ME BAZAT E BESIMIT

Pyetja e parë: *Cili është përkufizimi i Teuhidit dhe cilat janë llojet e tij?*

Përgjigje: Përkufizimi i Teuhidit është: *Bindja që njeriu duhet të ketë lidhur me njësimin e Allahut, i Cili është i Vetmi që ka cilësi të përsosura, duke besuar me bindje të plotë dhe duke e pohuar. Gjithashtu, të besojë se Ai nuk ka ortak e as shok dhe se Ai është i Vetmi që meriton të adhurohet nga të gjithë krijesat, pa përjashtim, si dhe i Vetmi që meriton të veçohet me të gjitha llojet e adhurimit*

Në këtë përkufizim përfshihen të tre llojet e teuhidit.

I pari: Teuhidi Rububije – Njësimi i Allahut në zotërim.

Do të thotë: Pohimi i njëshmërisë së Zotit, duke e njohur Atë si të Vetmin që krijon, furnizon, sistemon dhe përkujdeset për krijesat.

I dyti: Teuhidul Esmai ues Sifat – Njësimi i Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij.

Do të thotë: Të pohosh për Allahun çdo gjë që Ai e ka pohuar për Vetën e Tij, apo e ka pohuar për Të i Dërguari i Tij, qofshin ato emra, apo cilësi që përftohen nga ato emra. Të besosh dhe t'i pohosh ato cilësi, duke mos i përngjasuar apo shëmbëllyer me cilësitë e krijesave, si dhe duke mos ua ndryshuar kuptimin e as duke i mohuar ato.

I treti: Teuhidi Uluhijeh - Njëshmëria e Allahut në adhurim. Do të thotë: Ta veçosh Allahun, Një të vetëm, me të gjitha llojet dhe kategoritë e adhurimit, duke i kryer ato posaçërisht vetëm për Të me sinqeritet të plotë ndaj Tij dhe duke mos i shoqëruar askënd tjetër në adhurim.

Këto janë llojet e teuhidit, pa përmbushjen e të cilave besimtari nuk mund të jetë njësues, derisa t'u përmbahet plotësisht dhe t'i përmbushë kërkesat që rrjedhin prej tyre.

Pyetja e dytë: *Ç'është Imani (besimi) dhe Islami, cilat janë parimet bazë të tyre?*

Përgjigje: Imani është pohimi me vendosmëri i të gjitha urdhëresave që Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!) kanë obliguar që t'i besojmë, duke përfshirë edhe ato vepra të cilat janë prej imanit.

Ndërsa Islami është: T'i dorëzohesh vetëm Allahut dhe të bindesh ndaj urdhërësve të Tij.

Parimet bazë të tyre janë ato që përmenden në këtë ajet fisnik:

قُولُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنْزِلَ إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ

“Ju (besimtarë) thoni: “Ne e besuam Allahun, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë fise), atë që iu dha Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar” (Bekare: 136).

Si dhe shpjegimi që Pejgamberi (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!) u ka dhënë atyre në hadithin e Xhibrilit ku thotë:

“Imani, është besimi te Allahu, te Engjëjt e Tij, te Librat e Tij, tek të Dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit dhe në paracaktimin e Tij, qoftë i mirë apo i keq.”

Ndërsa për Islamin tha: *“Islami përkufizohet: Të dëshmosh se nuk e meriton të adhurohet askush me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të vizitosh Qaben duke bërë haxhin”*¹.

Në këtë hadith, Pejgamberi (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!) e shpjegoi Imanin me bindjet e zemrës, ndësa Islamin me zbatimin e dispozitave fetare të dukshme.

Pyetja e tretë: *Cilat janë bazat e besimit te emrat dhe cilësitë e Allahut?*

Përgjigje: Bazat e besimit te emrat dhe cilësitë e Allahut janë tre:

- 1- T’i besosh të gjithë emrat e bukur të Allahut.
- 2- Të besosh në cilësitë e përftuara prej emrave të Allahut.
- 3- Të besosh në atë çfarë vjen si rrjedhojë e atyre cilësive²

¹ Transmeton Imam Muslimi.

² Sh.red.: Shembull i kësaj është pohimi i emrit të Allahut *es-Semi`u* (Dëgjuesi i gjithçkaje). Në këtë rast, pohojmë emrin *es-Semi`u* si një nga emrat e Allahut, pohojmë cilësinë e dëgjimit që ky emër mbart, si dhe pohojmë atë që vjen si rrjedhojë e asaj cilësie, pra, faktin se Allahu dëgjon gjithçka dhe çdokënd, në detaje, ashtu siç i takon madhështisë së Tij.

Shembull: Ne besojmë se Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe se Ai ka dije të plotë, e cila përfshin çdo gjë. Besojmë se Ai është i Gjithëfuqishëm, ka fuqi absolute, me anë të së cilës mund të bëjë gjithçka. Besojmë se Ai është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirues. Mëshira e Tij është e gjerë dhe Ai mëshiron kë të dojë. Kështu themi për të gjithë emrat dhe cilësitë e tjera, si dhe çfarë vjen si rrjedhojë e atyre cilësive.

Pyetja e katërt: *Cili është mendimi i saktë, lidhur me lartësimin e Allahut mbi krijesat e Tij dhe qëndrimin e Tij mbi Arsh?*

Përgjigje: Ne kemi bindjen e plotë, se Zoti ynë është i Lartësuar mbi çdo gjë me kuptimin e plotë të fjalës:

- 1- I lartësuar me qenien e Tij.
- 2- I lartësuar në pozitën dhe cilësitë e Tij.
- 3- I lartësuar në sundimin dhe pushtetin e Tij.

Ne besojmë në faktin që Allahu është i veçuar nga krijesat e Tij. Ai është i lartësuar mbi Arshin e Tij, ashtu siç e ka përshkruar Ai veten. Lartësimi i Tij dihet, ndërsa mënyra se si është Lartësuar Ai, është e panjohur. Ai na ka lajmëruar se është i Lartësuar, por nuk na ka treguar mënyrën se si.

Kështu themi për të gjitha cilësitë e Krijuesit: Ai na ka lajmëruar për to, por nuk na ka treguar në detaje se si janë ato. Ndaj është obligim për ne që të besojmë tek gjithçka që Ai na ka qartësuar në Librin e Tij, apo nëpërmjet të Dërguarit të Tij. Ne nuk shtojmë e as nuk mohojmë asgjë prej tyre.

Pyetja e pestë: *Ç'mendim keni në lidhje me Mëshirën, si dhe me zbritjen e Tij në qiellin e dynjasë, apo cilësi të tjera të ngjashme me këto?*

Përgjigja: Ne besojmë dhe pranojmë çdo cilësi me të cilën Allahu e ka cilësuar veten e Tij, të tilla siç janë: Mëshira, Kënaqësia, Zbritja, Ardhja, etj. Gjithashtu iu besojmë të gjitha cilësive, me të cilat e ka përshkruar i Dërguari i Tij (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!). Ne i besojmë të gjitha ato cilësi, duke qenë të bindur se askush prej krijesave të Tij nuk i përngjan Atij në to, sepse askush nuk është si Ai.

Ashtu sikurse Allahut të Lartësuar nuk i përngjan asnjë qenie tjetër, po ashtu edhe cilësive të Tij nuk i përngjajnë cilësitë e asnjë qenieje tjetër. Argument për këtë është shtjellimi që është bërë në Librin e Allahut dhe në Sunetin e Pejgamberit, ku ndër të tjera përmendet lavdërimi i Allahut

me ato cilësi, si dhe argumentet që kanë ardhur në mënyrë të përgjithshme, të cilat hedhin poshtë ekzistencën e çdo shëmbëlltyre, ortaku, të barabarti, apo të ngjashmi me Të.

Pyetja e gjashtë: *Cila është bindja juaj në lidhje me Fjalën e Allahut, Kuranin?*

Përgjigje: Ne besojmë se Kurani është fjalë e Allahut. Kurani është zbritur prej Tij dhe nuk është krijuar. Allahu është thënësi dhe iniciuesi dhe tek Ai do të kthehet Kurani, ashtu siç na ka lajmëruar për këtë Profeti (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!). Me të vërtetë, Allahu është thënësi i Tij, i fjalëve dhe kuptimeve të tij. Allahu ka folur dhe flet atë që dëshiron dhe kur të dëshirojë. Fjalët e Tij nuk shterojnë dhe nuk kanë të sosur.

Pyetja e shtatë: *Ç'është besimi i plotë? A është e mundur që besimi të shtohet dhe pakësohet?*

Përgjigje: Besimi është termi që përfshin bindjen e zemrës dhe veprat e saj, dhe ai shprehet me anë të gjuhës dhe gjymtyrëve. E gjithë feja, me bazat dhe degët e saj përfshihen në termin e besimit. Rrjedhimisht, ai shtohet kur forcohet bindja që gjendet në zemër, po ashtu kur shtohen veprat e mira, ndërsa pakësohet nëse ndodh e kundërta (me dobësimin e bindjes dhe kryerjen e mëkateve).

Pyetja e tetë: Si vlerësohet besimi i një mëkatari musliman?

Përgjigje: Ai i cili është besimtar; njësuës i Allahut, por herë pas here bie dhe në mëkate, konsiderohet besimtar në përputhje me atë nivel të besimit që ka, dhe nga ana tjetër, ai është gjynahqar për mangësitë e tij në lidhje me obligimet e besimit. Besimtari që e ka besimin e mangët, nga njëra anë i meriton përfitimet e premtuara për shkak të besimit të tij, por nga ana tjetër është i ekspozuar ndaj dënimit, si pasojë e gjynaheve të tij. Megjithatë, edhe nëse dënohet për mëkatet e tij, qëndrimi i tij nuk do të jetë i përhershëm në Zjarrin e Xhehenemit.

Besimi i plotë është e vetmja mënyrë e sigurt që të mbron nga hyrja në Zjarrin e Xhehenemit, por megjithatë, besimi edhe nëse është i mangët, nuk lejon qëndrimin e përhershëm në të.

Pyetja e nëntë: *Sa janë kategoritë e besimtarëve në varësi të veprave të tyre dhe cilat janë ato?*

Përgjigje: Besimtarët ndahen në tre kategori:

- 1- Besimtarë që paraprijnë në punë të mira. Konsiderohen ata besimtarë që i kryejnë obligimet dhe veprat e pëlqyeshme, si dhe largohen nga ndalesat dhe veprat e papëlqyeshme.

- 2- Mesatarët. Konsiderohen ata besimtarë, të cilët mjaftohen me kryerjen e obligimeve dhe largimin nga veprat e ndaluara.
- 3- Të padrejtët, që e kanë ngarkuar veten e tyre. Në këtë kategori bëjnë pjesë ata besimtarë që i kanë përzier punët e mira me punë të këqija.

Pyetja e dhjetë: *Si qëndron çështja në lidhje me veprat e njerëzve?*

Përgjigje: Veprat e njerëzve, qofshin ato të mira apo të këqija, janë të përfshira në krijimin e Allahut dhe në caktimin e Tij, por njerëzit janë ata që i veprojnë ato punë. Allahu i Lartësuar nuk i ka detyruar njerëzit që t'i kryejnë ato. Njerëzit i kryejnë veprimet me vullnetin e tyre dhe për to do të shpërblehen apo do të ndëshkohen. Ato vepra janë realisht prej krijimit të Allahut, sepse Ai i ka krijuar njerëzit; ka krijuar dëshirën e tyre, aftësinë e tyre për të vepruar, si dhe çdo gjë që ndodh si pasojë e kësaj. Ne i besojmë të gjitha argumentet nga Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit, të cilat tregojnë se krijimi i Allahut dhe fuqia e Tij përfshijnë çdo gjë, qofshin ato krijesa me logjikë apo jo, qofshin cilësi apo vepra. Ashtu siç i besojmë edhe argumentet nga Libri i Allahut dhe Suneti, të cilat tregojnë se

njerëzit janë vepruesit realë të së mirës dhe së keqes. Ata posedojnë lirinë e zgjedhjes dhe vullnetin e kryerjes së veprimeve të tyre. Allahu është Krijuesi i aftësisë dhe dëshirës së njerëzve, të cilat (dëshira dhe aftësia) janë shkak për ekzistencën e veprimeve dhe fjalëve të tyre. Ai që e krijon shkakun është edhe krijuesi i pasojës. Allahu është më Madhështori dhe më i Drejti. Ai nuk i imponon njerëzit në kryerjen e veprimeve të tyre.

Pyetja e njëmbëdhjetë: *Ç'është shirku (idhujtaria) dhe si ndahet ai?*

Përgjigje: Shirku është:

1. Idhujtaria në *Rububije* (zotërim). Ai është besimi i njeriut se Allahu ka ortak në krijimin e krijesave, apo në përkujdesjen ndaj tyre.
2. Idhujtaria në *Uluhiye* (adhurim). Ky lloj i shirkut ndahet në dy pjesë: Shirk i madh dhe shirk i vogël.
 - a) Shirku i madh ndodh atëherë kur njeriu ia kushton dikujt tjetër përveç Allahut ndonjë prej llojeve të

adhurimit. Si për shembull: t'i lutet dikujt tjetër përveç Allahut, të shpresojë prej tij apo t'i frikësohet atij.³

Ky lloj shirku të nxjerr nga Islami, dhe nëse njeriu vdes pa u penduar prej tij, do të jetë përgjithmonë në Zjarr.

- b) Shirku i vogël i referohet atyre shkaqeve që mund të çojnë tek idhujtaria, si p.sh: betimi për dikë tjetër përveç Allahut, syfaqësia, etj., me kusht që të mos kenë arritur gradën e adhurimit (sepse nëse e arrijnë gradën e adhurimit atëherë konsiderohet shirk i madh).

Pyetja e dymbëdhjetë: *Si mund ta përshkruajmë besimin tek Allahu në mënyrë më të shtjelluar?*

Përgjigje: Ne e pranojmë bindshëm me zemrat tona dhe e pohojmë me gjuhët tona se:

Allahu është Krijuesi i gjithçkaje që ekziston.

³Sh.red.: Të shpresojë tek dikush tjetër, ndërsa duhet të shpresojë vetëm te Allahu për çështje të tilla si, sigurimi i furnizimit, shërimi i të sëmurit, falja e mëkateve, hyrja në Xhenet, etj.; apo të ketë frikë nga dikush tjetër veç Allahut për çështje që duhet t'i frikësohet vetëm Allahut, siç është oguri i keq, dënimi në Botën tjetër, etj. Nuk bën pjesë në frikën e ndaluar frika e natyrshme, e cila ekziston tek njeriu, si p.sh: frika nga egërsira, nga keqbërësit, etj.

Ai është Një i Vetëm, nuk ia ka nevojën askujt, ndërkohë që të gjithë kanë nevojë për Të.

Është i veçuar me të gjitha cilësitë e përsosmërisë, lavdisë dhe madhështisë.

Ai është i Përsosur në mënyrë absolute në çdo aspekt, aq sa krijesat nuk mundën ta perceptojnë, apo ta përfshijnë me dijen e tyre madhësitë dhe përsosmërinë e atyre cilësive.

Ai është i Pari, para të Cilit nuk ka qenë askush.

Ai është i Fundit, pas të Cilit nuk mbetet më askush.

Ai është i Larti, mbi të Cilin nuk është askush.

Ai është i Afërti dhe më afër se Ai s'është askush.

Ai është më i Larti, i Lartësuar me qenien e Tij, me pozitën e Tij dhe me sundimin e Tij.

Ai është i Gjithëdijsëm për çdo gjë.

Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Ai është Dëgjuesi i të gjithë zërave, pavarësisht shumëllojshmërisë së gjuhëve dhe larmishmërisë së kërkesave.

Ai është Shikuesi i çdo gjëje.

Ai është i Urti në krijimin dhe ligjvënien e Tij.

Ai është i Lavdëruari në cilësitë dhe veprat e Tij.

Ai është i Madhëruari në madhështinë dhe krenarinë e Tij.

Ai është Mëshiruesi, i Gjithëmëshirshmi, mëshira e të Cilit ka përfshirë gjithçka. Bujaria, mirësia dhe dhurimi i Tij kanë përfshirë çdo gjë që ekziston.

Ai është Poseduesi i gjithçkaje. Sunduesi i të gjitha mbretërive. Sundimi është cilësi e pandashme e Tij. E gjithë bota e sipërme dhe e poshtme janë të nënshtruar dhe robër të Tij. Atij i takon pushteti absolut. Ai është i Gjalli, gjallëria e të Cilit është përsosmërisht e plotë, gjallëri kjo, që i përfshin të gjitha cilësitë e Tij qenësore.

Ai është Përkujdesësi i Përherëshëm, Mbajtësi i gjithçkaje, i Cili nuk ia ka nevojën askujt dhe asgjëje.

Ai është i përshkruar me cilësitë vepruese⁴ ashtu siç i përkasin madhësisë së Tij, Ai bën çfarë të dëshirojë dhe

⁴Cilësitë vepruese janë ato të cilat Allahu i vepron kur të dojë si të dojë, si psh: ardhja në Ditën e Gjykimit, zemërimi, e qeshura, etj.

ajo që Ai dëshiron bëhet, ndërsa ajo që Ai nuk e dëshiron nuk mund të ndodhë.

Dëshmojmë se Zoti ynë është Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi (Ai që u ka dhënë formën krijesave). Ai i krijoi ato në mënyrën më të përsosur dhe me një sistem të përkryer.

Si dhe dëshmojmë se Ai është Allahu (i Adhuruari), përveç të Cilit nuk ka asnjë të adhurar me të drejtë dhe me meritë. Adhurimi i takon vetëm Atij dhe askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij.

Prandaj, nuk i përulemi dhe nuk i nënshtrohemi dhe nuk i drejtohem (për çdo nevojë) askujt tjetër, përveç Allahut, të Vetmit, Ngadhënjësit, të Plotfuqishmit, Krenarit, Mëkatfalësit. Vetëm Atë adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, tek Ai shpresojmë dhe vetëm Atij i frikësohemi.

Shpresojmë në mëshirën e Tij dhe i frikësohemi dënimit të Tij, i cili mund të shkaktohet nga mëkatet tona dhe në përmbushje të drejtësisë së Tij. Nuk ka Zot tjetër përveç Tij, të cilit t'i lutemi e t'i kërkojmë ndihmë, e as të adhurar tjetër përveç Tij, prej të cilit mund të shpresojmë. Ai është Mbrojtësi dhe Ndihmuesi ynë që na përmirëson fenë tonë dhe dynjanë tonë. Ai është Ndihmësi më i mirë, i Cili largon prej nesh çdo gjë të keqe dhe të vështirë.

Pyetja e trembëdhjetë: *Si duhet të jetë besimi ynë në lidhje me Pejgamberët, në mënyrë të shtjelluar?*

Përgjigje: Është detyrë për ne t'i besojmë të gjithë Pejgamberët dhe të Dërguarit, për të cilët është vërtetuar se janë Pejgamberë dhe të Dërguar, në mënyrë të përgjithshme dhe specifike.

Besojmë se Allahu i Lartësuar i ka dalluar ata me shpalljen e Tij, duke i bërë ndërmjetës mes Tij dhe robërve të Tij në komunikimin e fesë dhe dispozitave të Tij. Ai i ka përkrahur ata me argumente (mrekulli) që tregonin për vërtetësinë e tyre dhe të shpalljes hyjnore që ata komunikan.

Pejgamberët dhe të Dërguarit janë krijesat më të përsosura në dije dhe në vepra, më të singertët, më të bindurit ndaj Allahut, më të devotshmit dhe më të përkryerit në sjellje. Allahu i Lartësuar i ka veçuar në vlera, aq sa nuk mund t'i arrijë në to askush. I ka ruajtur dhe distancuar nga prirjet negative dhe veset e ulëta. Pejgamberët dhe të Dërguarit ishin të pagabueshëm në lidhje me çfarë përcollën nga Allahu. Çdo gjë që ata përcollën ishte e vërtetë, e papërzier me të kotën. Duhet të besohen që të gjithë ata, si dhe të besohet çdo gjë që ata komunikan nga Zoti. Për ne është obligim që t'i duam, t'i nderojmë dhe t'i respektojmë. Ne

e besojmë, e duam, e nderojmë dhe e respektojmë Pejgamberin tonë, Muhamedin (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!) vulën e profetëve, në mënyrën më të plotë. Ne duhet që ta njohim atë, si dhe të njohim shpalljen që solli, në mënyrë të përgjithshme dhe të shtjelluar, sipas mundësisë. Duhet që ta besojmë atë që ai ka kumtuar dhe përcjellë, të kapemi pas saj, t'i besojmë lajmet e tij, t'i bindemi urdhrat të tij e të largohemi nga çdo gjë që ai e ka ndaluar. Duhet të besojmë se Muhamedi (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!) është vula e Pejgamberëve, nuk ka Pejgamber pas tij. Legjislacioni i tij i ka shfuqizuar të gjithë legjislacionet e mëparshme, dhe është i vetmi legjislacion i i vlefshëm deri në Ditën e Gjykimit. Besimi në të Dërguarin e Allahut, nuk mund të jetë i plotë nëse nuk besojmë në gjithçka të cilën ai komunikoi. Mendja e shëndoshë si dhe argumentet e bazuara në përvojën njerëzore dhe dukuritë e prekshme, dëshmojnë për vërtetësinë dhe besueshmërinë e Pejgamberit (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!)

Pyetja e katërmëdhjetë: *Sa janë bazat e besimit në caktimin e Allahut dhe cilat janë ato?*

Përgjigje: Ato janë katër baza, pa të cilat besimi në caktimin e Allahut nuk është i plotë. Ato janë:

- 1- Të besosh se Allahu është i Gjithëdijshtëm për gjithçka dhe se dija e Tij është gjithëpërfshirëse e çdo gjëje që ndodh, në mënyrë të përgjithshme dhe të hollësishme.
- 2- Të besosh se Ai e shkroi këtë në *Leuhul Mahfudh* (në Librin e ruajtur tek Ai).
- 3- Të besosh se gjithçka që ndodh përmbushet me Dëshirën dhe Fuqinë e Tij. Ajo që Allahu dëshiron të ndodhë, ndodh patjetër, ndërsa ajo që Ai nuk dëshiron, nuk mund të ndodhë.
- 4- Të besosh se Allahu iu ka mundësuar njerëzve që t'i kryejnë veprimet e tyre, me zgjedhjen dhe vullnetin e tyre. Ata i kryejnë ato vepra me dëshirën dhe aftësinë e tyre, pa qenë të imponuar.

Ndër argumentet treguese për këto baza është fjala e Allahut të Lartësuar:

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِنَّ ذَلِكَ فِي كِتَابٍ

“A nuk e ke ditur se Allahu di gjithçka që ekziston në qiell dhe në tokë?! E tërë ajo është e shënuar në Libër” (Haxh: 70).

Si dhe fjala e Tij:

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ وَمَا تَشَاوُرُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

“Për atë prej jush që dëshiron të ecë në rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi diçka, vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve!” (Tekuir: 28-29)

Pyetja e pesëmbëdhjetë: *Çfarë përfshin besimi në Ditën e Gjykimit?*

Përgjigje: Gjithçka e përmendur në Kuran dhe Sunet, prej çështjeve që kanë të bëjnë me ndodhitë pas vdekjes, përfshihet tek besimi në Ditën e Gjykimit. Për shembull, ndodhitë e varrit, përjetimet në të, qofshin ato kënaqësi apo vuajtje. Ndodhitë e Ditës së Gjykimit siç janë: marrja në llogari, shpërblimi, ndëshkimi, shpalosja e fletushkave (me veprat e njerëzve), peshorja e veprave, ndërmjetësimi, etj. Gjithashtu, këtu përfshihen përjetimet në Xhenet dhe në Xhehenem, përshkrimi i tyre, si dhe përshkrimi i banorëve të tyre dhe i asaj që Allahu ka përgatitur për ta, në mënyrë të përgjithshme dhe të hollësishme. Të gjitha këto janë pjesë e besimit në Ditën e Gjykimit.

Pyetja e gjashtëmbëdhjetë: *Ç’është hipokrizia (nifaku)? Cilat janë llojet dhe shenjat e saj?*

Përgjigje: Përkufizimi i hipokrizisë është: Shfaqja e së mirës dhe fshehja e ligësisë. Ajo ndahet në dy lloje:

- 1- Nifaku i madh (hipokrizia në besim), e cila bëhet shkak që personi i tillë të jetë përjetësisht në Zjarr.

Për këtë lloj të hipokrizisë na ka treguar Allahu në fjalën e Tij:

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

“Ka prej njerëzve që thonë: ‘Ne e kemi besuar Allahun dhe Ditën e Fundit (Ahiretin)’, por në realitet ata nuk janë besimtarë” (Bekare: 8)

Pra, janë ata njerëz që fshehin mosbesimin dhe shfaqin Islamin.

- 2- Nifaku i vogël (hipokrizia në vepra).

Shembull për të është shpjegimi i Pejgamberi (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!) ku thotë:

“Shenjat e hipokritit janë tre: kur flet gënjen, kur premtim e thyen premtimin, e nëse i besohet diçka, tradhton.”⁵

⁵Transmeton Imam Buhariu dhe Imam Muslimi.

Njeriut nuk i bëjnë dobi as besimi e as veprat, në prani të Kufrit të madh apo Nifakut të madh.

Ndërsa Kufri i Vogël apo Nifaku i Vogël (syfaqësia) mund të ndodhë që të ekzistojnë tek njeriu njëkohësisht me besimin. Pra, tek i njëjti njeri ndodh që të ekzistojë e mira dhe e keqja, si dhe të bashkohen tek ai shkaqet e shpërblimit nga njëra anë dhe shkaqet e dënimit në anën tjetër.

Pyetja e shtatëmbëdhjetë: *Çfarë është bidati dhe cilat janë llojet e tij?*

Përgjigja: Bidati (shpikja në fe) është e kundërta e Sunetit.

Ai është dy llojesh:

- 1- Bidatet (shpikjet apo shtesat) në besim, të cilat janë: të besosh diçka tjetër, të ndryshme nga ajo që Allahu i ka kumtuar të Dërguarit të Tij.

Në lidhje me këtë Pejgamberi (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Umeti im do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe dhe që të gjitha do të jenë në zjarr përveç njërit prej tyre.” E pyetën: “Cili është ai grup i shpëtuar o i Dërguari i Allahut?” Ai tha:

“Është ai që i përmbahet fesë (rrugës dhe metodologjisë) në të cilën jam unë dhe shokët e mi.”⁶

Besimtari që i përmbahet këtij përshkrimi konsiderohet pasues i Sunetit (traditës profetike, rrugës profetike), ndërsa kush bën pjesë në grupet e tjera konsiderohet bidatçi (i devijuar). S’ka dyshim se çdo bidat (risi në fe) është lajthitje dhe devijim. Bidatet nuk janë të gjitha të një niveli, ato ndryshojnë në varësi të largësisë dhe mospërputhjes që kanë me Sunetin.

- 2- Lloji i dytë është bidati në vepra. Ky lloj bidati përfshin kryerjen e adhurimeve në mënyrë të ndryshme nga ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij ka ligjëruar.

Gjithashtu, këtu përfshihen edhe rastet kur dikush e konsideron si të *ndaluar diçka*, ndërkohë që ajo nuk është ndaluar nga Allahu dhe as nga i Dërguari i Tij.

Personi që kryen një adhurim pa pasur për të ndonjë argument fetar, apo konsideron si të ndaluar diçka që Ligjvënësi (Allahu) nuk e ka ndaluar, ai ka shpikur në fe (ka bërë bidat).

⁶Transmeton Imam Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Ebu Davudi. Hadithin e ka saktësuar shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!).

Pyetja e tetëmbëdhjetë: *Cilat janë të drejtat e ndërsjella që muslimanët kanë mes tyre?*

Përgjigja: Allahu i Lartësuar thotë:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër.” (Huxhurat 10)

Duhet që t’i konsiderosh ata vëllezër, të duash për ta atë të mirë që dëshiron për vete, si dhe të mos ua dëshirosh të keqen, ashtu siç nuk e dëshiron për veten tënde. Të përpjeksh t’i ndihmosh ata në çështje të dobishme, të mundohesh që t’i pajtosh ata, t’i afrosh zemrat e tyre dhe t’i bashkohsh në atë që është e drejtë.

Muslimani është vëlla për muslimanin, nuk i bën padrejtësi atij, nuk e lë në baltë, nuk e gënjen dhe as nuk e përçmon.

Ky ishte shpjegimi, përse i përket vëllazërisë së përgjithshme, duke mos lënë mënjanë njerëzit, ndaj të cilëve kemi obligime të posaçme, siç janë prindërit, farefisi, fqinjët, mësuesit dhe shokët.

Pyetja e nëntëmbëdhjetë: *Çfarë obligimesh kemi kundrejt shokëve të Pejgamberit (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!)?*

Përgjigje: Ndër kushtet për përmbushjen e besimit tek i Dërguari i Allahut (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!) dhe dashurisë ndaj tij, janë:

- Të duam shokët e tij, sipas gradave që ata kanë në mirësi dhe sipas hershmërisë së tyre në Islam.
- T'i njohim vlerat që kanë, me anë të së cilave, ata u dalluan nga i gjithë umeti.
- Dashurinë për ta, lëvdimin e tyre dhe përhapjen e mirësisë së tyre, t'i konsiderojmë bindje dhe adhurim për Allahun.
- Prej edukatës dhe respektit ndaj tyre është që të tregohemi të matur dhe të rezervuar, në lidhje me mosmarrëveshjet që ndodhën mes tyre.
- Të besojmë se ata janë njerëzit më të nderuar dhe më të lavdëruar të këtij umeti. Ata ishin të parët në kryerjen e veprave të mira dhe më të distancuarit nga çdo e keqe.
- Të besojmë se të gjithë ata ishin njerëz të drejtë, me integritet të lartë moral dhe se Allahu është i kënaqur me ta.

Pyetja e njëzetë: *Cili është qëndrimi fetar në lidhje me zgjedhjen (caktimin) e kryetarit të shtetit?*

Përgjigja: Besojmë se zgjedhja e kryetarit të shtetit është detyrë kolektive (*fard kifajeh*) e një populli. Duke qenë se njerëzit e kanë të domosdoshme përzgjedhjen e një prijësi, i cili angazhohet për rregullimin dhe mbarëvajtjen e çështjeve të tyre jetësore. Ai i mundëson besimtarëve që të kryejnë obligimet fetare, merr përsipër organizimin e mbrojtjes së vendit nga çdo kanosje ose rrezik, si dhe garanton zbatimin e drejtësisë, e në veçanti ekzekutimin e penalteteve ndaj shkelësve të ligjit. Përderisa ai përzgjidhet për drejtimin e shtetit dhe i besohet kjo detyrë, natyrshëm lind obligueshmëria për bindje ndaj tij, në gjërat e drejta e të mbara dhe që nuk bien në kundërshtim me ligjin e Allahut, në mënyrë që pushteti i tij të jetë i plotë dhe funksional. Gjithashtu, përpjekja në rrugën e Allahut është e vlefshme nën udhëheqjen e tij, pavarësisht faktit nëse ai është ose jo i devotshëm. Për ne është detyrë që të jemi përkrah tij, në çdo vepër të mirë, si dhe t'i ofrojmë këshillën e sinqertë sa herë të jetë e nevojshme.

Pyetja e njëzet e një: *Ç'është Rruga e drejtë dhe cilat janë veçoritë e saj?*

Përgjigje: Rruga e drejtë është dituria e dobishme dhe puna e mirë.

Dija e dobishme është dituria e Kur'anit dhe Sunetit, të cilën e komunikoi i Dërguari i Allahut (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!).

Puna më e mirë është adhurimi i Allahut me besim të saktë, kryerja e detyrimeve (farzeve) që Ai ka vendosur, si dhe e veprave të mira vullnetare (nafile). Gjithashtu dhe distancimi nga veprat e ndaluara. Kjo nënkupton: Të kryesh detyrimet që ke ndaj Allahut, si dhe detyrimet ndaj robërve të Tij. Diçka e tillë nuk mund të arrihet ndryshe vetëm se me sinqeritet të plotë ndaj Allahut dhe duke pasuar të Dërguarin e Tij (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!).

E gjithë feja sillet rreth këtyre dy bazave. Atij që i humbet sinqeriteti, bie në shirk (idhujtari), ndërsa ai që humbet pasimin e të Dërguarit bie në bidat (bën risi në fe).

Pyetja e njëzet e dy: *Cilat janë cilësitë që e dallojnë besimtarin nga mohuesi dhe refuzuesi i së vërtetës?*

Përgjigje: Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme. Duke njohur dallimet mes besimtarit dhe të tjerëve arrin të dallosh mes të vërtetës dhe të kotës, mes njerëzve të lumtur dhe të dëshpëruar. Dije se besimtari i vërtetë është ai, i cili beson tek Allahu, tek emrat dhe cilësitë e Tij, të cilat janë përcjellë në Kuran dhe Sunet, duke i kuptuar dhe pranuar ato, si dhe duke besuar në dëlirësinë e Allahut nga çdo gjë që bie ndesh me to. Në këtë mënyrë, zemra e besimtarit mbushet me besim, dituri, bindje, qetësi dhe lidhet fortë me Allahun. Ai i drejtohet vetëm Allahut, adhuron vetëm Allahun, me adhurimet të cilat Ai i ka ligjëruar nëpërmjet Pejgamberit të Tij (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!), duke i kryer ato vetëm për Të, duke shpresuar shpërblimin e Tij dhe duke u frikësuar nga dënimi i Tij.

Ai e falënderon Allahun me zemrën, me gjuhën dhe me gjymtyrët e tij për mirësitë që Ai i ka dhënë dhe bujarinë e madhe që Ai ka shpalosur, begatitë e shumta me të cilat ai është i rrethuar. Ky lum mirësish nga Zoti i tij e nxit njeriun që të mos reshtë së përmenduri Atë (me dhikër dhe falënderim).

Besimtari që e përjeton këtë gjendje, nuk sheh asnjë mirësi më të madhe se sa ajo në të cilën ndodhet dhe as nderim më të madh se ai. Atij nuk i hyjnë në sy kënaqësitë materiale të kësaj bote, kur i krahason me kënaqësinë që ndjen kur kthehet tek Allahu dhe i drejtohet Atij. Pavarësisht kësaj, ai nuk e privon veten nga kënaqësitë e kësaj jete, por jo siç kënaqen mohuesit apo të shkujdesurit, përkundrazi, ai kënaqet me to duke u ndihmuar për kryerjen e obligimeve që ka ndaj Allahut dhe ato që ka ndaj njerëzve.

Me këtë bindje dhe duke pasur këtë shpresë, kënaqësia e tij kompletohet, zemra e tij rehatohet, shpirti i tij qetësohet dhe nuk mërzhitet nëse çështjet nuk i vijnë ashtu siç ai dëshiron dhe planifikon. Këtij besimtari Allahu i ka mundësuar dy lumturitë: lumturinë e dynjasë dhe atë të Ahiretit.

Nga ana tjetër, njeriu mohues dhe i shkujdesur është në një gjendje krejt tjetër. Ai e ka mohuar Zotin e tij Madhështor, për të Cilin dëshmojnë argumentet logjike, argumentet fetare (Kurani dhe Suneti), njohuritë elementare dhe shqisat. Mohuesi i shpërfill të gjitha këto argumente bindëse, duke mos e njohur dhe duke mos e adhuruar Allahun. Pasi e ndërpret lidhjen me Allahun, jepet pas materializmit

duke e shndërruar atë në idhull.⁷ Preokupimi i tij kryesor ngjason me atë të bagëtive, të cilat nuk kanë angazhim tjetër përveçse të ngopen. Zemra e tij është përherë e trazuar dhe e frikësuar se mos humbet diçka prej të mirave që ai gëzon apo se mos i ndodh ndonjë gjë e padëshiruar. Mungesa e besimit ia bën të vështirë përballimin e fatkeqësive dhe zbutjen e brengave. Ai është i privuar nga kënaqësia e besimit dhe nga ëmbëlsia e adhurimit të Allahut. E ka privuar veten nga shijimi i fryteve të besimit, disa prej të cilave janë të shpejta dhe disa të tjera të mëvonshme. Ai nuk shpreson ndonjë shpërblim (nga Zoti) dhe nuk i frikësohet ndëshkimit, por frika dhe shpresa e tij janë të lidhura vetëm me dëshirat vetjake materiale që kanë të bëjnë me jetën dhe ekzistencën e tij të përkohshme në këtë botë. Ndër veçoritë dalluese ndërmjet besimtarit dhe mohuesit theksojmë:

Besimtari karakterizohet nga nënshtrimi ndaj së vërtetës dhe vlerësimi i këshillës së ndërsjellë mes njerëzve, qoftë ajo

⁷Sh.red.: Këtë gjendje të mohuesve e gjejmë të përshkruar në ajetin kuranor, ku Allahu thotë: "A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti (kafshë). Madje, ata janë edhe më të humbur (se sa kafshët) nga rruga e drejtë." El Furkan, 43-44.

me fjalë, me vepra apo me nijet⁸. Ndërsa mohuesin e karakterizon mendjemadhësia ndaj së vërtetës dhe ndaj krijesave, pëlqimi i vetvetes dhe moskëshillimi nga askush.

Besimtari e ka zemrën të pastër nga dashakeqësia, mashtrimi, smira dhe urrejtja. Ai dëshiron për të tjerët atë që dëshiron për veten e tij, si dhe urren për ta atë që urren për veten e tij. Ai përpiket t'ju vijë në ndihmë të tjerëve sipas mundësisë, është i durueshëm ndaj lëndimeve që të tjerët i shkaktojnë, nuk u bën padrejtësi atyre në asnjë lloj forme. Nga ana tjetër mohuesi, nuk karakterizohet nga altruizmi, vetëm në rast se edhe ai ka ndonjë interes apo përfitim të caktuar. Atij nuk i bën përshtypje padrejtësia që mund të ushtrojë ndaj njerëzve kur ka fuqi për ta bërë diçka të tillë dhe njëkohësisht është më i paduruari dhe më i papërmbyturi, nëse dikush i cënon interesat e tij.

Besimtari është i sinqertë dhe i vërtetë në atë që thotë dhe i sjellshëm me njerëzit. Cilësitë e tij janë: urtësia, maturia, qetësia, mëshira, durimi, besnikëria, përmbushja e amanetit, i lehtë në bashkëpunim dhe ka natyrë të butë. Ndërsa cilësitë e mohuesit janë: pamaturia, harbutëria, pander-

⁸Shën. red.: Besimtari këshillon me fjalë, jep shembullin e tij të mirë me vepra dhe dëshiron të mirën për ta.

shmëria, pakënaqësia dhe ankesa, gënjeshtër, mos përmbushja e amanetit dhe sjellja e ashpër.⁹

Besimtari nuk i përulet askujt tjetër përveç Allahut. Ai e ruan zemrën dhe personalitetin e tij nga përlulja ndaj dikujt tjetër veç Zotit të tij. Ai është i cilësuar me: ndershmëri, forcë, trimëri, bujari, integritet moral dhe mirësjellje. Ai nuk pranon asgjë tjetër përveç asaj që është e mirë dhe e pastër. Kurse gjendja e mohuesit është tërësisht e kundërt me këtë.

Zemra e tij është e lidhur me krijesat, ka frikë nga dëmi i tyre dhe shpreson të mirën e tyre. Ai përdhos personalitetin e tij për ta. Nuk ka nder dhe moral, nuk ka qëndrueshmëri dhe nuk ka iniciativa përveçse për synimet e tij vetjake. Atij i mungon dinjiteti dhe humanizmi. Atij nuk i bën përshtypje se çfarë fiton apo vepron, të pastrën apo të pistën.

Besimtari angazhohet njëkohësisht, në ndërmarrjen e shkaqeve të suksesit (duke studiuar, punuar, etj) dhe i

⁹Shën.red.: Këto përshkrime të sipërpërmendura i referohen parimisht dallimeve që ekzistojnë ndërmjet besimtarit dhe mohuesit, por kjo nuk do të thotë detyrimisht që çdo besimtar karakterizohet nga të gjitha vlerat e lartpërmendura, ashtu siç jo detyrimisht çdo mohues karakterizohet nga vetitë negative të mësipërme.

mbështetet Allahut, duke ia dorëzuar çështjet Atij. Besimtari i kërkon ndihmë Zotit në çdo gjë dhe s'ka dyshim se Allahu i Lartësuar do të jetë në ndihmën e tij. Ndërsa mohuesi nuk e di se ç'është mbështetja tek Allahu. Ai nuk mbështetet askund tjetër, përveçse tek vetja e tij e dobët dhe e pafuqishme. Allahu e ka lënë atë në zgjedhjen që ka bërë, e ka braktisur dhe nuk e ndihmon në synimet e tij. Edhe nëse mohuesit i mundësohet ajo që synonte, në të vërtetë, ajo nuk është mirësi për të, por është thjesht një përshkallëzim që e shpie dalëngadalë drejt përballjes me shkatërrimin.

Nëse besimtarit i vjen ndonjë mirësi, ai e pret atë me mirënjohje dhe falënderim dhe e përdor për çështje të dobishme.

Kurse mohuesi e pret atë me mosmirënjohje dhe mendjemadhësi. Ai angazhohet me begatinë duke e harruar Begatuesin, e për rrjedhojë as nuk e falënderon Atë. Ai e shfrytëzon atë mirësi për synimet e tij të ulëta, e për këtë arsye ajo largohet shpejt prej tij. Besimtarit kur i vijnë sprovat i pret me durim, duke shpresuar shpërblim prej Allahut dhe shpreson që ato t'i largohen. Kështu, mirësia dhe shpërblimi që i vijnë prej kësaj sprove janë më të

mëdha se ato që humbi prej gjërave që i donte dhe i eklipsojnë gjërat e urryera që i ndodhën.

Ndërsa mohuesi i pret këto sprova me panik dhe i alarmuar, tërë kohës duke u ankuar, prandaj i shtohet edhe më tepër mjerimi. Në këtë mënyrë atij i dyfishohet dhembja, duke e vuajtur së jashtmi dhe së brendshmi. Ai nuk bën durim dhe as nuk shpreson ndonjë shpërblim. Sa i thellë është mjerimi i tij dhe sa e madhe është fatkeqësia e tij!

Një aspekt dallues i rëndësishëm ndërmjet besimtarit dhe mohuesit është qëndrimi që mbajnë ndaj profetëve dhe të dërguarve të Zotit. Besimtari i beson të gjithë të Dërguarit, i respekton dhe i nderon ata. Dashuria që ka për ta është më e madhe se dashuria që ka për gjithë njerëzit e tjerë. Ai është i bindur se çdo mirësi që u vjen njerëzve deri në Ditën e Gjykimit është si pasojë e ndjekjes dhe zbatimit të thirrjes së tyre (Profetëve) dhe udhëzimit që ata përcollën nga Zoti i tyre. Ndërsa çdo e keqe dhe dëm që u vjen njerëzve është si pasojë e kundërshtimit dhe mosndjekjes së porosive të tyre.

Profetët ishin më të vyerit mes besimtarëve dhe më të dobishmit për ta, e në veçanti më i përzgjedhuri ndër ta dhe vula e të gjithë profetëve Muhamedi (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!), të cilin Allahu e dërgoi si mëshirë

për të gjithë botët. E dërgoi atë si përmirësues, duke i udhëzuar njerëzit drejt çdo mirësie.

Kurse gjendja e mohuesve është e kundërt me këtë, ata i madhërojnë armiqtë e të Dërguarve dhe i nderojnë fjalët e tyre. Ata tallen në të njëjtën mënyrë siç u tallën të parët e tyre me fenë që përcollën të Dërguarit. Ky është argumenti më i madh që tregon cektësinë e mendjes së tyre dhe nivelin e ulët të moralit të tyre. Besimtari e ka pjesë të besimit të tij dashurinë për sahabët, shokët e Pejgamberit (Paqja dhe lavdërimi e Allahut qofshin mbi të!) dhe për dijetarët muslimanë, të cilët ftojnë për në udhëzim. Ndërsa tek mohuesit diçka e tillë nuk ekziston. Besimtari, duke qenë i sinqertë me Allahun, punon për hir të Tij dhe u vjen në ndihmë robërve të Tij. Mohuesi, me punët e tij nuk synon asgjë tjetër përveçse që të përmbushë interesat vetjake dhe epshet e tij. Shpirti i besimtarit është i qetë, për shkak të dijes së dobishme dhe besimit të vërtetë që ai mbart. E si të mos jetë ashtu përderisa zemra e tij është e orientuar nga Allahu?! Ai nuk resht së përmenduri Zotin e tij, është bamirës ndaj krijesave dhe me ndërgjegje të pastër, për shkak të distancimit nga e keqja dhe veset e ulëta. Kurse mohuesi, i shkujdesuri, është e kundërta e kësaj sepse ai i ka humbur shkaqet që të sjellin qetësinë e shpirtit.

KAPITULLI I DYTË

ÇFARË I PENGON NJERËZIT NGA BESIMI?

Nëse dikush thotë: “Përderisa besimi i saktë është ashtu siç e cilësuat në përmbledhjen tuaj të mësipërme, pra që me anë të tij arrihet lumturia e afërt dhe e largët dhe se ai (besimi i saktë) e përmirëson gjendjen e brendshme dhe të jashtme të njeriut, duke ngulitur parimet e shëndosha, bindjet e sakta dhe moralet fisnike, e gjithashtu, duke i ftuar njerëzit të kryejnë punë të dobishme dhe të drejta... Pra, nëse është kështu, atëherë përse shumica e njerëzve janë indiferentë ndaj fesë dhe besimit, madje disa prej tyre edhe i kundërvihen apo tallen me të?! Përse të mos ndodhte e kundërta (d.m.th që njerëzit të ishin besimtarë)? Sidomos kur dihet se njerëzit kanë logjikë dhe intelekt, gjë e cila i bën ata të aftë për të zgjedhur për veten e tyre të mirën në vend të së keqes, të dobishmen në vend të të dëmshmes, të vlefshmen në vend të së kotës?

Përgjigje: Këtë çështje e ka përmendur Allahu në Librin e Tij, duke treguar shkaqet e vërteta që i pengojnë njerëzit nga besimi. Nëse njeriu sheh se si trajtohet në Kuran përgjigja e pyetjes së parashtruar, atij nuk i mbetet më asnjë lloj paqartësie lidhur me arsyen e indiferencës së shumicës së

njerëzve ndaj fesë dhe besimit. Allahu i Lartësuar ka përmendur pengesa të shumta, të cilat qëndrojnë si barriera ndërmjet njerëzve dhe fesë islame. Ndër barrierat kryesore përmendim:

1- Injoranca rreth fesë Islame; pra mosnjohja e saj siç duhet, si dhe mungesa e studimit të parimeve dhe udhëzimeve të përsosura të saj.

Padija mbi njohuritë bazë është pengesa më e madhe për të arritur tek e vërteta e pamohueshme dhe për të përfutur pajisjen me moralet fisnike. Allahu i Lartësuar thotë:

بَلْ كَذَّبُوا بِمَا لَمْ يُحِيطُوا بِعِلْمِهِ وَلَمَّا يَأْتِهِمْ تَأْوِيلُهُ

"Por ata e përgënjeshtrojnë atë (Kuranin) pa e shqyrtuar atë (në mënyrë që ta kuptonin) dhe pa iu ardhur shpjegimi i tij" (Junus: 39).

Në këtë ajet Allahu i Lartësuar na tregon se përgënjeshtrimi i tyre erdhi si pasojë e injorancës së tyre dhe mosperceptimit të përmbajtjes së tij. Pra, ata nuk pritën që t'u vinte sqarimi i Kuranit, e as nuk shfaqën interes që të njihnin domethëniet e tij, por nxituan që ta përgënjeshtrojnë dhe refuzojnë atë.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ يَجْهَلُونَ

"Por shumica e tyre tregohen injorantë (ndaj tij)" (En'am: 111).

Si dhe ka thënë:

وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ

"Por shumica e tyre nuk dinë" (En'am: 37).

Gjithashtu ka thënë:

صُمُّ بُكْمٌ عُُمِّيٌّ فَهُمْ لَا يَعْقِلُونَ

"Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër dhe ata nuk kuptojnë" (Bekare: 171).

Dhe:

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ

"Me të vërtetë në këtë ka argumente për një popull që arsyeton" (Rum: 24).

Këto janë vetëm disa nga argumentet të cilat hedhin dritë lidhur me këtë çështje.

Injoranca ndahet në dy kategori, e thjeshtë dhe komplekse.

Injoranca e thjeshtë është gjendja e atyre njerëzve, të cilët për shkak të mendjelehtësisë së tyre i përgënjeshtrojnë të Dërguarit dhe e refuzuan thirrjen e tyre, duke mos bërë as përpjekjen më minimale për ta shqyrtuar.

Ndërsa **injorancën komplekse** mund ta ndajmë në dy lloje: Në llojin e parë bëjnë pjesë ata njerëz, të cilët zgjedhin të jenë në fenë e paraardhësve të tyre dhe të rrethit shoqëror, në të cilin rriten dhe jetojnë. Kur këtyre njerëzve u ofrohet e vërteta, ata as nuk e marrin mundimin që t'ia hedhin sytë, por edhe nëse ia hedhin sytë, do të jetë një shikim përciptazi sepse ata zgjedhin me fanatizëm që të mbeten në fenë në të cilën janë rritur, pa marrë në konsideratë se sa e saktë dhe e vërtetë është. Shumica e njerëzve që kanë përgënjeshtrojnë të Dërguarit dhe e kanë refuzuar thirrjen e tyre bënë pjesë pikërisht në këtë kategori. Në lidhje me ta Allahu i Lartësuar ka thënë:

كَذَلِكَ مَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي قَرْيَةٍ مِّنْ نَّذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِم مُّقْتَدُونَ

"Kështu, Ne nuk dërguam para teje ndonjë paralajmërues (Profet) në ndonjë vendbanim, e që të mos i kenë thënë

pasanikët nga mesi i tyre: 'Ne i gjetëm paraardhësit tanë në këtë fë, dhe ne do të ndjekim gjurmët e tyre' (Zuhruf: 23).

Ata nuk bënë gjë tjetër, veçse i pasuan verbërisht paraardhësit e tyre. Njerëzit e këtillë mendojnë se kanë bërë zgjedhjen e duhur, por në realitet ata kanë gabuar në zgjedhjen e tyre. Po ashtu, në këtë grupim bëjnë pjesë shumica e mohuesve, të cilët janë të prirur drejt materializmit. Nëse do të analizonim njohuritë e tyre, do të vërenim se ato nuk janë gjë tjetër veçse pasim i verbër dhe imitim i pikëpamjeve ideologjike të parisë së tyre. Sa herë që paria e tyre artikulon diçka, ata e pranojnë menjëherë sikur të ishte revelatë e zbritur nga qielli. Nëse paria proklamon ndonjë teori të gabuar, ata nuk kundërshtojnë të shkojnë pas tyre, pavarësisht nëse pajtohen apo jo me atë teori.

Në këtë mënyrë, influenca e parisë bëhet sprovë për çdokënd, i cili nuk i logjikon vetë gjërat, por preferon që të logjikojnë të tjerët për të. Ky arsyetim nuk do t'ju shërbejë aspak si justifikim Ditën e Gjykimit, megjithëse ata do tentojnë të justifikohen me të, ashtu siç na tregon Allahu i Lartësuar se kur ata t'i prekë dënimi do të thonë:

وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَضَلُّونَا السَّبِيلَا

“Ata do të thonë: Zoti ynë! Ne iu bindëm parisë dhe pasuam udhëheqësit tanë, por ata na humbën nga rruga e drejtë.”
(Ahzab: 67).

Në llojin e dytë të **inJORANCËS komplekse** bëjnë pjesë shumë nga ideologët dhe mendimtarët ateistë, të cilët u fokusuan dhe u specializuan në shkencat e natyrës dhe studimit të universit, duke i zhvlerësuar njohuritë e të tjerëve dhe e kufizuan dijen vetëm në atë që ata dinë, e cila në fakt nuk është tjetër veçse një dije e pjesshme, me një fokus të ngushtë, madje shpeshherë e ngritur mbi supozime dhe hipoteza. Kjo kategori e njerëzve, të vetëkënaqur me arritjet dhe njohuritë e tyre, i refuzuan parimet dhe normat që të Dërguarit komunikuan nga Zoti i tyre, duke treguar arrogancë dhe mendjemadhësi ndaj profetëve dhe pasuesve të tyre. Ata pretendojnë se njohuri të pranuarja janë vetëm ato që mund të perceptohen nëpërmjet shqisave dhe metodave eksperimentale, ndërsa çdo gjë tjetër përveç kësaj e refuzojnë dhe e përgënjeshtrojnë, sado e saktë që të jetë. Pikërisht nga ky botëkuptim i tyre i ngushtë, ata nuk ngurruan të mohojnë Zotin e gjithësisë, i Cili i krijoi nga asgjëja. Ata përgënjeshtrojnë të Dërguarit e Allahut, si dhe çdo gjë që Ai shpalli nëpërmjet tyre në lidhje me çështjet që

kanë të bëjnë me *gajbin*.¹⁰ Për këtë kategori mohuesish, Allahu i Lartësuar na ka treguar në Kuranin Famëlartë:

فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرَحُوا بِمَا عِنْدَهُمْ مِنَ الْعِلْمِ وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِؤُونَ

"Kur atyre u erdhën të Dërguarit me argumente të qarta, ata iu gëzuan diturisë së vet dhe atëherë e merituan atë (dënimin) me të cilin talleshin " (Gafir: 83)

Vetëkënaqësia e tyre me njohuritë që kanë dhe mjeshtëritë që zotërojnë është shkaku kryesor, i cili i shtyn ata të mbahen fort pas së kotës, madje t'i japin asaj përparësi përkundrejt udhëzimit dhe diturisë që sollën Profetët. Ata nuk mjaftohen me aq, por edhe tallen me njohuritë e të Dërguarve duke i përçmuar ato, por në realitet vetë ata do të jenë të përçmuarit, të cilët do të përballen me ndëshkimin e talljeve të tyre. Shumë prej studiuesve dhe intelektualëve, të cilët e kanë angazhuar jetën e tyre në studimin e njohurive bashkëkohore, u ndikuan nga ideologjia ateiste dhe teoritë që kanë lidhje me të, veçanërisht për shkak të

¹⁰Sh.p.:Të besosh në *gajb* do të thotë të besosh në çdo gjë të padukshme, për të cilën na ka lajmëruar Allahu i Madhëruar apo Pejgamberët e Tij. Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Gajbi është dija që është e fshehur për njerëzit. Pjesë e kësaj është Xheneti e Xhehenemi dhe lajme të tjera që përmenden në Kur'an dhe Sunet."

mosrënies në kontakt me fenë dhe besimin,¹¹ dhe kjo për arsye se sistemi arsimor nuk i ka dhënë rëndësi mësim-besimit, i cili do t'i mbronte ata nga ateizmi. Shumë nga këta studiues të shkencave bashkëkohore e mbajnë veten sikur gëzojnë njohuri të vlefshme dhe që i favorizojnë në pozita shoqërore, e kjo i bën ata që ta përçmojnë fenë dhe besimtarët, të cilët diskriminohen disi dhe mënjanohen nga qarqet intelektuale. Për rrjedhojë, kjo kategori studiuesish e ka shumë të lehtë që t'u bindet ateistëve materialistë.

Ndaj dhe obligimi parësor i muslimanëve karshi aspektit arsimor në shkollat e tyre duhet të jetë:

- Të kenë synim parësor që nxënësit të edukohen me parimet fetare, të pajisen me edukatë islame, si dhe të njohin normat bazë të fesë së tyre.
- Lëndëve fetare t'u jepet rëndësia e duhur, ashtu siç iu jepet njohurive të tjera dhe jo të konsiderohen si lëndë dytësore.

Këto duhet të jenë prej prioriteteve kryesore të atyre që janë përgjegjës për hartimin dhe implementimin e kurrikulave në sistemin arsimor. Kjo përgjegjësi bie edhe mbi mësuesit, të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me brezin e ri.

¹¹Nxënësi që del nga këto shkolla, nuk është edukuar me njohuritë e duhura fetare dhe nuk është stolisur me moralin e fesë.

Suksesi i rinisë sonë kushtëzohet pikërisht nga edukimi i duhur sipas asaj që thamë mësipër, prandaj le të kenë frikë Zotin të gjithë ata, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë nën përgjegjësinë e tyre edukimin e brezave. Ata duhet që t'i përfshijnë lëndët fetare duke i bërë ato pjesë të programit mësimor, madje duke u dhënë rëndësinë që u takon. Neglizhenca në këtë drejtim do të sillte pasoja negative në jetën shoqërore dhe individuale, si dhe largim të njerëzve nga feja dhe besimi, për faktin se ajo që iu garanton njerëzve lumturinë dhe mirëqenien e dëshiruar (në këtë botë dhe Ahiret) është pikërisht jeta nën hijen e besimit.

2- *Një tjetër barriere që i pengon njerëzit nga përqafimi i fesë dhe besimit është smira dhe urrejtja.*

Shembull ilustrues i kësaj barriere është rasti i jehudive (çifutëve), të cilët e njihnin Pejgamberin (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!), ashtu siç njihnin fëmijët e tyre. Ata ishin të bindur për vërtetësinë e tij dhe e njihnin qëllimin e fesë, me të cilën ai u dërgua, e megjithatë ata e fshehën të vërtetën me vetëdije të plotë. Ata i dhanë përparësi më tepër interesave dhe përfitimeve materiale të jetës së kësaj bote, kundrejt besimit dhe ndjekjes së Pejgamberit.

Ishte pikërisht ky shkaku, i cili e pengoi shumicën e parisë së Kurejshëve që ta pranonin Islamin, siç edhe dihet nga referencat historike në lidhje me ta. Kjo sëmundje vjen si pasojë e mendjemadhësisë, e cila është pengesa më e madhe për të pranuar të vërtetën. Allahu i Lartësuar ka thënë:

سَأَصْرِفُ عَنْ آيَاتِيَ الَّذِينَ يَتَكَبَّرُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ

"Unë do t'i shmang nga argumentet e Mia ata të cilët pa asnjë të drejtë bëjnë kryelartësi në tokë " (A'raf: 146).

Mendjemadhësia është refuzimi i së vërtetës dhe përçmimi i njerëzve. Pikërisht, kjo sëmundje e rëndë shpirtërore i ka penguar shumë njerëz që ta pasojnë të vërtetën e t'i nënshtrohen asaj, megjithëse atyre u bëhen të qarta argumentet. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَجَحَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنْفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُفْسِدِينَ

"Padrejtësisht, e me mendjmadhësi ata i mohuan argumentet e së vërtetës, edhe pse në veten e tyre ishin të bindur për vërtetësinë e tyre. Shiko pra se si ishte fundi i shkatërrimtarëve!" (Neml: 14).

- 3- *Një tjetër barrierë që i pengon njerëzit nga feja dhe besimi është gjithashtu indiferentizmi ndaj argumenteve të sakta, qofshin ato argumente fetare ose logjike.*

Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَنْ يَعِشْ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُفِضَ لَهُ شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ وَإِنَّهُمْ لَيَصُدُّونَهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ مُّهْتَدُونَ

"Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një shejtan, i cili nuk i ndahet kurrë. E ata (shejtanët) do t'i shmangin ata nga rruga e drejtë, e ndërkohë (jobesimtarët) mendojnë se janë në rrugën e duhur " (Zuhruf: 36-37).

Në një ajet tjetër ka thënë:

وَقَالُوا لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِ

"(Jobesimtarët) thanë: "Sikur të kishim qenë nga ata që dëgjonin dhe logjikonin (në dunja), nuk do të ishim (sot) ndër banuesit e zjarrit." (Mulk: 10).

Janë ata, të cilët do të dëshmojnë kundër vetes së tyre se nuk ua kishin vënë veshin këshillave profetike dhe as nuk kishin arsyetuar në lidhje me mesazhin hyjnor; se nuk treguan interes (sa ishin në këtë botë) për dijen e të Dërguarve dhe të Librave që Allahu zbriti. Janë ata që nuk e përdorën mendjen në mënyrën e duhur që t'i udhëzonte tek e vërteta (besimi), por ndoqën mendime dhe teori të gabuara, të cilat i konsideronin mençuri dhe urtësi, e që në realitet ishin larg nga udhëzimi. Pasimi i verbër që ata u

bënin prijësve të tyre të humbur, i pengoi nga pasimi i së vërtetës, deri sa përfunduan në zjarrin e Xhehenemit. Eh, sa vendbanim i keq është ai i mendjemëdhenjve!

4- *Një nga shkaqet që e pengojnë njeriun nga pasimi i së vërtetës është edhe refuzimi i saj pasi që ajo iu është bërë e qartë.*

Nëse njeriut i bëhet e qartë e vërteta, me argumentet përkatëse, e megjithatë, ai e refuzon atë, atëherë ndëshkohet me përmbysjen e botëkuptimeve, duke e parë të mirën si të keqe dhe të keqen si të mirë.

Allahu i Lartësuar thotë:

فَلَمَّا رَأَوْا أَرْأَعَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ

"E kur ata u shmangën (nga e vërteta), Allahu i devijoi zemrat e tyre" (Saf: 5).

Gjithashtu ka thënë:

وَنُفِّلَ أَفْئِدَتَهُمْ وَأَبْصَارَهُمْ كَمَا لَمْ يُؤْمِنُوا بِهِ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَنَذَرَهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ

"Ne do t'ua shmangim zemrat dhe shikimet e tyre nga e vërteta, ashtu siç ata u shmangën dhe nuk besuan herën e

parë. Do i lëmë të bredhin të verbër në lajthitjen dhe arrogancën e tyre.” (En'am: 110).

Kjo ndodh sepse shpërblimi është sipas natyrës së veprës.

Një shembull të ngjashëm e gjejmë në një tjetër ajet Kuranor, në të cilin Allahu na tregon se si i lë mohuesit në atë që zgjodhën për veten e tyre:

إِنَّهُمْ اتَّخَذُوا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ

“Ata (të humburit) i zgjodhën shejtanët për miq” (A'raf: 30)

5- Një tjetër barrierë penguese nga besimi është edhe teprimi në qejfe dhe përjetime të kësaj bote, si dhe tejkalimi i caqeve në mirëqenie, duke kaluar në shpërdorim dhe zhytje në të ndaluarat.

Kjo e bën njeriun që të ndjekë tekat dhe epshet e tij, e t'u robërohet atyre, duke i bërë dëm vetes.

Këtë barrierë, e gjejmë të përmendur në disa ajete kuranore, si psh:

بَلْ مَتَّعْنَا هَؤُلَاءِ وَآبَاءَهُمْ حَتَّى طَالَ عَلَيْهِمُ الْعُمُرُ

"Por Ne u mundësua atyre dhe paraardhësve të tyre që të përjetojnë të mira dhe kënaqësi, e kështu ata jetuan për një kohë të gjatë (të mashtruar me gjendjen e tyre)." (Enbija: 44)

Në një tjetër ajet Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّهُمْ كَانُوا قَبْلَ ذَلِكَ مُتْرَفِينَ

"Ata përpara kësaj (dënimit në Xhehenem) kanë qenë të dhënë pas luksit dhe shpërdorimit." (Vakia: 45)

Kur atyre u erdhi feja e vërtetë, e cila e disiplinonte mënyrën e jetesës së tyre, duke kërkuar ruajtjen e ekuilibre midis kënaqësive të lejuara të dynjasë dhe kryerjes së obligimeve fetare, ata e konsideruan këtë si një pengesë nga të mirat që kishin.

Njeriu i cili nuk ka synim tjetër përveçse të arrijë përmbushjen e tekave dhe kënaqësive të kësaj bote, bën çmos që t'i ruajë ato nga çdo gjë që mund t'ia cënojë apo kufizojë. Prandaj kur atyre u erdhi feja e cila në çdo gjë kërkon ruajtjen e sensit të masës dhe e ndalon shpërdorimin, si dhe i urdhëronte ata që të adhuronin Allahun, ta falënderonin për mirësitë që u kishte dhënë, dhe i ndalonte nga shthurja dhe tejkalimi i kufinjve, ata e refuzuan dhe i kthyen shpinën.

- 6- *Një tjetër barrierë, e cila i largon njerëzit nga besimi është përçmimi që mohuesit shprehin ndaj të Dërguarve dhe pasuesve të tyre, me pretendimin se ata janë njerëz të ulët dhe të pavlerë.*

Kjo mënyrë gjykimi i shtynte njerëzit që të talleshin me besimtarët. Një nga këto shembuj që Allahu i Lartësuarna ka treguar është për popullin e Nuhut:

قَالُوا أَنْتُمْ مِنْ لَكَ وَاتَّبَعَكَ الْأَرْذَلُونَ

"Ata thanë: "E si të të besojmë ty (o Nuh), kur ty të besojnë më të ulët?" (Shuara: 111)

Gjithashtu thanë:

مَا نَرَاكَ إِلَّا بَشَرًا مِثْلَنَا وَمَا نَرَاكَ اتَّبَعَكَ إِلَّا الَّذِينَ هُمْ أَرَادُوا بِآدِي الرَّأْيِ وَمَا نَرَى لَكُمْ عَلَيْنَا مِنْ فَضْلٍ

"Ne nuk po shohim se të pason dikush tjetër, përveç atyre që janë më të ulëtit e më mendjelehtët nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne." (Hud: 27)

Kjo sjellje përçmuese vjen si pasojë e mendjemadhësisë. Nëse dikush tregohet mendjemadh, vetëpëlqyes dhe e përçmon tjetrin, atëherë ai e ka të vështirë që ta pranojë të vërtetën që i shfaqet nëpërmjet këtij personi. E sikur po të

njëjt person, t'i vinte kjo e vërtetë nga dikush tjetër, për të cilin ai ka konsideratë, ai do ta kishte pranuar atë.

7- *Një tjetër barrierë, e cila i pengon njerëzit nga besimi është shfrenimi dhe mosnjohja e kufinjve.*

Allahu i Lartësuar thotë:

كَذَلِكَ حَقَّقْتُ كَلِمَتُ رَبِّكَ عَلَى الَّذِينَ فَسَقُوا أَنَّهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ

“Në këtë mënyrë përmbushet Fjala e Zotit tënd (vendimi i Tij) ndaj atyre që janë të shfrenuar, se ata nuk do të besojnë.” (Junus: 33).

Shfrenimi nënkupton shmangien e zemrës së njeriut nga bindja ndaj Allahut, duke kaluar në bindje ndaj shejtanit. Kjo është një nga pengesat më të mëdha për pranimin e së vërtetës, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Për këtë shkak, Allahu i Lartësuar nuk e pastron njeriun që është në këtë gjendje, por e lë atë të braktisur në veten e tij zullumqare, prandaj ai endet i dalldisur në humbjen dhe arrogancën e tij. Një njeri i tillë, të gjitha veprimet dhe sipërmarrjet e tij i ka negative dhe plotë ligësi. Shfrenimi dhe shthurja e afrojnë atë me të kotën dhe e zmbrapsin nga e vërteta; sepse nëse zemra i largohet bindjes ndaj Allahut dhe përuljes ndaj Tij, patjetër që do t'i bindet çdo... *“...shejtani të mallkuar. Është vendim i padiskutueshëm se*

cilido që e miqëson atë (shejtanin), ai ka për ta humbur dhe ka për ta orientuar për në vuajtjet e Zjarrit përvëlues."
(Haxh: 3-4).

- 8- *Ndër pengesat më të mëdha të njeriut që e largojnë nga besimi dhe nga pasimi i së vërtetës është kufizimi i njohurive dhe i të vërtetave vetëm në një rreth të ngushtë, siç bëjnë ateistët, të cilët e kufizojnë dijen vetëm në çfarë perceptohet prej shqisave.* Atë çfarë shqisat e perceptojnë, ata e pranojnë, ndërsa atë që shqisat nuk arrijnë ta perceptojnë ata e refuzojnë, madje edhe nëse ajo vërtetohet me mënyra dhe argumente më të mëdha e më të qarta se perceptimi sipërfaqësor shqisor. Ky lloj arsyetimi i mangët është bërë shkak që tek shumë njerëz të lindin dyshime dhe keqkuptime në lidhje me besimin.

Nisur nga kjo mënyrë e gabuar dhe dashakeqe e arsyetimit, ata shkojnë aq larg, sa të mohojnë ekzistencën e Zotit. Gjithashtu, përgënjeshtrojnë Profetët dhe lajmet që ata sollën në lidhje me të fshehtën (gajbin), për vërtetësinë e të cilave dëshmojnë argumente të ndryshme dhe të shumta. Prej fakteve të pakundërshtueshme që dihen është edhe fakti se argumentet që përforcojnë vërtetësinë mbi ekzistencën e Zotit, mbi njëshmërinë e Tij dhe se Ai është i vetmi Krijues e Sistemues, janë aq të dukshme dhe të qarta,

saqë nuk mund të krahasohet me to asnjë mënyrë tjetër e të argumentuarit.

Ky fakt dëshmohet me argumentet fetare (Kurani dhe tradita profetike), me argumentet logjike dhe po ashtu dëshmon natyrshmëria e pastër e njeriut.

Allahu ka shpalosur argumente të qarta në gjithësi dhe në brendësi të vetes sonë, me anë të të cilave qartësohet e vërteta; që Ai është i vërtetë dhe që të Dërguarit e Tij janë të vërtetë, që shpërblimi i Tij është i vërtetë dhe që të gjitha lajmet e Tij janë të vërteta, që feja e Tij është e vërtetë, e ç'mund të ketë tjetër pas së vërtetës përveç humbjes?!

Kjo është mëse e qartë! Pavarësisht rebelimit të materialistëve dhe mendjemadhësisë së tyre, e cila bëhet pengesë mes tyre dhe të vërtetës. S'ka dyshim se kujt i humbet kjo e vërtetë (e njohjes së besimit), asgjë nuk i bën dobi. Besimtari mendjemprehtë arrin të dallojë me dritën e besimit se ata ndodhen në një humbje të qartë dhe në një verbim të thellë. Falënderojmë Allahun për mirësinë e udhëzimit!

9- Një tjetër barrierë penguese që e mban larg njeriun nga besimi është pretendimi i materialistëve dhe i njerëzve që janë mashtruar prej tyre, se: njerëzimi, pjekurinë e tij dhe

përsosmërinë e logjikës e ka arritur vetëm në këtë kohë moderne, në të cilën kanë mbizotëruar njohuritë shkencore dhe materializmi, ndërsa njerëzit që kanë jetuar më herët, nuk e kishin arritur pjekurinë e mjaftueshme logjike dhe për rrjedhojë, nuk mund të shërbejnë si referencë, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë shkencor.

Është e qartë, për çdo njeri që ka sadopak logjikë dhe nuk është i ndikuar nga idetë e gabuara, se ky është një pretendim tërësisht i pavend, sofizëm dhe këmbëngulje kokëforte ndaj të vërtetave. Nëse ata do të pretendonin se zhvillimi teknik e industrial, shpikjet e shumta dhe larmishmëria e shfrytëzimit të burimeve natyrore kanë arritur kulmin e tyre në kohët e sotme, atëherë, ky do të ishte pretendim i pranueshëm nga të gjithë. Mirëpo kjo nuk u jep të drejtë për të pretenduar refuzimin e të vërtetave të pakontestueshme, të cilat as nuk varen nga nocioni kohë dhe as nuk ndikohen nga zhvillimet materialiste. Pra, feja Islame dhe parimet e saj, besimi në njëshmërinë e Zotit, si dhe vlerat morale në tërësi, janë të qëndrueshme dhe nuk ndryshojnë.¹²

¹²Sh.red: Besimi te Zoti, Një i vetëm, Krijuesi, Sunduesi dhe Sistemuesi i gjithësisë, nuk ndryshon në varësi të kohës apo modernizimit të jetës së njeriut. Gënjeshtra, mendjemadhësia, vjedhja, etj., kanë qenë, janë dhe do të jenë mëkate.

Të pretendosh pavlefshmërinë e besimit dhe moralit, për shkak se ato janë vlera të trashëguara nga kohë në të cilat mungonte zhvillimi teknologjik dhe modernizimi aktual, konsiderohet ndër pretendimet më absurde.

Vërtetësia ose pasaktësia e një ideologjie, apo e një teorie të caktuar, nxirret në pah nëpërmjet studimit të synimeve dhe qëllimeve të saj, shqyrtimit të argumenteve mbi të cilat ajo bazohet, si dhe përmes fryteve dhe ndikimeve të saj.

Në këtë kontekst, nëse studiojmë Islamin, parimet dhe synimet e tij, ligjet dhe dispozitat, argumentet mbi të cilat bazohet, do të vërejmë përsosmërinë dhe harmoninë madhështore që gjendet në të. Islami garanton lumturinë e njeriut, jo vetëm në Botën tjetër, e cila është lumturia absolute dhe e pashtershme, por edhe lumturinë e kësaj jete. Islami demonstroi besimin e pastër monoteist, fton në përsosjen e moralit, duke qenë pjesë e rëndësishme e misionit të profetit Muhamed (Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të!), i cili u dërgua si mëshirë për të gjithë botët dhe në veçanti, për të përsosur vlerat morale.

Kur muslimanët i vunë në jetë dhe i zbatuan me përpikmëri këto parime dhe vlera madhështore, ata arritën pikun e mirëqënies shpirtërore dhe sociale dhe jetuan krenarë, duke

udhëhequr popuj të tërë që nga Lindja deri në Perëndim, për shekuj me rradhë,. Ata arritën majat në të gjitha fushat e jetës: shpirtërore, sociale, shkencore, etj.

Nga ana tjetër, nëse do vërejmë sjelljet e materialistëve të pafë, të cilët i kanë lëshuar tërësisht frerët e epsheve dhe tekave të tyre, duke mos u ndalur para asnjë pengese apo kufiri, do të gjejmë se kanë rënë në nivelet më të ulëta të dinjitetit njerëzor dhe integritetit moral. Sikur të mos ishte për disa vlera universale të mbetura akoma tek ata, si dhe falë zhvillimit industrial ekonomik të tyre, shturja dhe shfrenimi moral do t'i shpinte drejt kaosit dhe shkatërrimit të sigurt:

وَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ غَافِلًا عَمَّا يَعْمَلُ الظَّالِمُونَ

"E ti kurrësi mos e mendo Allahun të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët. " (Ibrahim: 42)

E nëse nuk do të ishin disa vlera morale të trashëguara nga feja, gjurmët e të cilave kanë mbetur tek popujt e përparuar materialisht dhe të cilat jua përmirësojnë disi jetën, përparimi i tyre material nuk do të kishte ndonjë vlerë për t'u përmendur, sepse ata të cilët e humbasin fenë nuk kanë mundësi të bëjnë një jetë të mirë, e as të gëzojnë qetësi, e lumturi. Aktualiteti që ne po jetojmë është shembulli më i

mirë për të argumentuar këtë fakt. Dihet nga të gjithë se Profetët janë dërguar me shpallje dhe udhëzim, të cilat përmbajnë parime të përgjithshme, por edhe dispozita të hollësishme. Ata përcollën tek njerëzit dritë dhe njohuri të sakta. Misioni i tyre ishte përmirësimi i shoqërisë në çdo aspekt.

Njerëzit e mençur dhe të llogjikshëm i kanë pranuar dhe mirëpritur shpalljet hyjnore dhe mësimet profetike, duke e ndjerë si nevojë të domosdoshme jetësimin e tyre. Ata u treguan të dëgjueshëm dhe i përmbushën porositë profetike sepse ata ishin të bindur se edhe sikur të mblidheshin të gjitha mendjet njerëzore, që nga i pari e deri tek i fundit, nuk do të arrinin dot dijen dhe njohuritë që gjenden në Librat e shpallur nga Allahu dhe të vërtetat e dobishme, të cilat u përcollën nga të Dërguarit. Ata ishin të bindur se nëse nuk do të ekzistonte ky udhëzim hyjnor, njerëzit do të ishin në humbje të qartë, në verbëri të plotë dhe në mjerim të vazhdueshëm deri në shkatërrim. Të vërtetën e ka thënë Zoti ynë në Librin e Tij famëlartë:

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ
وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِنْ كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ

*“Padyshim që Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve,
kur nga mesi i tyre u dërgoi Pejgamber, që t'u lexojë atyre*

shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata nga mëkatet, t'ua mësojë Librin dhe Urtësinë (Kuranin dhe Sunetin), ndërkohë që ata më parë ishin në humbje të qartë." (Al Imran: 164)

Mendja nuk mund të arrijë pjekurinë e duhur dhe përsosmërinë, veçse nëpërmjet dijeve që Profetët sollën nga Zoti. Për këtë arsye, mendimet dhe argumentet që kundërshtojnë udhëzimin hyjnor dhe diturinë profetike, nuk kanë kurrfarë peshe apo vlere. Shumë njerëz janë mashtruar pas slloganeve boshe, me të cilat synohet zbukurimi i së kotës dhe kundërshtimi i së vërtetës, duke u treguar mendjelehtë dhe sipërfaqësorë. Kjo dukuri ndodh ngaqë njohuritë fetare dhe moralin e lartë të fesë ata e quajten prapambetje, ndërsa njohuritë dhe sjelljet e tjera që janë në kundërshtim me to i quajnë kulturë dhe përparim.

Dihet nga të gjithë se çdo kulturë dhe civilizim që nuk është themeluar mbi udhëzimet fetare dhe këshillat e fesë, mbetet kulturë e mangët dhe civilizim i brishtë. Dëmi që shkakton ky civilizim i cunguar është më i madh sesa dobia dhe kjo gjë do të shfaqet qartë herët apo vonë, në këtë botë apo në botën tjetër.

Islami i udhëzon dhe i nxit njerëzit që t'i arrijnë të dyja lumturitë dhe të dyja të mirat (ato të kësaj bote dhe të Botës

Tjetër). Ai që mediton rreth vlerave, parimeve dhe dispozitave që Islami solli, do të bindet se e mira e njerëzimit arrihet vetëm duke e përqaftuar këtë fë madhështore, si dhe duke zbatuar udhëzimet dhe porositë e saj të vyera. Po ashtu, do të bindet edhe për faktin se ashtu siç kjo fë ka përcjellë besimin e saktë dhe ka përsosur moralin, duke e ngritur dinjitetin njerëzor në shkallën më të lartë, po ashtu është në gjendje të përmirësojë dhe përsosë edhe sferat e tjera të jetës.

S'ka dyshim se Islami udhëzon drejt çdo vlere që i sjell dobi dhe mirësi individit dhe mbarë shoqërisë.

Suksesi është vetëm prej Allahut, Ai është Udhëzuesi!

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA E AUTORIT.....	4
KAPITULLI I PARË.....	5
ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME LIDHUR ME BAZAT E BESIMIT	5
KAPITULLI I DYTË.....	38
ÇFARË I PENGON NJERËZIT NGA BESIMI?	38